

# STRATEGJITË EFEKTIVE TË TË KUPTUARIT E LEXIMIT FILLESTAR

## EFFECTIVE EARLY READING COMPREHENSION STRATEGIES

Arbresha ZENKI-DALIPI<sup>1</sup>

<sup>1</sup>*Department of Teacher Education, Faculty of Pedagogy, University of Tetova*

*\*Corresponding author e-mail: arbresha.zenki@unite.edu.mk*

---

### Abstract

The avalanche of changes that constantly attack education imposes on us the indisputable need to change the way of reorganizing the structure of the lesson, they require new creative approaches according to the needs, interests, and possibilities of the students. Such opportunities allow devices with systematic and operational knowledge which will enable them to use them in different situations when solving problems in a creative way, specifically through the implementation of different strategies. The writing elaborates the effective strategies of reading comprehension as an integral didactic activity to achieve the goals and objectives laid out in the teaching work.

In addition to the harmonization of the expected effects, in this context, we talk about the learning strategy, by which we understand the ways that are applied through which the learning technology is changed and adapted, the architecture of the lesson, as well as the concept of transferring learning information. This paper presents strategies for reading to: identify key information and ideas, relate prior knowledge, encourage meaningful interaction with the text, foster active and critical skills. Also, this includes monitoring and evaluation before, during and after reading.

**Keywords:** Strategies, effective, reading, reading comprehension.

### Përmbledhje

Orteqet e ndryshimeve që vazhdimisht atakojnë arsimin, na imponojnë nevojën e pakontestueshme që ta ndërrojmë edhe mënyrën e riorganizimit të strukturës së orës, kërkojnë qasje të reja kreative konform nevojës, interesit dhe mundësisë së nxënësve. Mundësitë e tilla lejojnë pajisje me dituri sistematike dhe operative të cilat do t'u mundësojnë t'i shfrytëzojnë në situata të ndryshme, me rastin e zgjidhjes së problemeve në mënyrë krijuese, konkretisht nëpërmjet zbatimit të strategjive të ndryshme. Shkrimi shtjellon strategjitë efektive të të kuptuarit të leximit si veprimtari integrale didaktike për t'i arritur qëllimet dhe objektivat e shtruara në punën mësimore.

Krahas harmonizimit të efekteve të pritura, në këtë kontekst flasim për strategjinë e të nxënësve, me të cilën kuptojmë rrugët që aplikohen dhe përmes të cilave ndryshohet e përshtatet teknologjia e mësimin, arkitektura e orës mësimore, si dhe koncepti i transferimit të informacioneve mësimore. Ky punim shpalos strategji me të cilat gjatë leximit: mundet të identifikohen informacione dhe ide kryesore, të ndërliqhen njohuri paraprake, të inkurajhet ndërveprim kuptimplotë me tekstin, të nxiten aftësitë aktive dhe kritike. Gjithashtu, këtu bën pjesë edhe monitorimi dhe vlerësimi para, gjatë dhe pas leximit.

**Fjalë kyçe:** Strategji, efektive, leximi, të kuptuarit e leximit.

---

## Strategjitë e instruktimit të të kuptuarit të leximit

Me qëllim të përpunimit të të lexuarës, lexuesit aplikojnë një numër të strategjive. Leximi strategjik lejon lexuesit të përpunojnë, organizojnë e vlerësojnë informacionin nga teksti. Sipas Paris, strategjitë e leximit vështirë mund të përcaktohen për shkak të tri arsyeve që ai nënvizon. Së pari thekson vështirësinë për të dalluar strategjitë e leximit nga strategjitë e mësimit, së dyti, vështirësinë për të përcaktuar fushëveprimin e strategjive dhe si të tretë nënvizon konsiderimin e strategjisë si të qëllimshme nga njëra palë përkundër të tjerëve që nuk shikojnë strategjitë si të tilla. (Paris, 1991). Strategjia përfshin veprim njerëzor, e kjo është qëllim i orientuar, i qëllimshëm, i vetëdijshëm dhe sjellje e kontrolluar (Dijk, 1983).

Strategjitë e të kuptuarit nuk janë më shumë se mjetet që lexuesit punësojnë në shërbim të ndërtimit të kuptimit nga teksti (Pressley, 2002). Strategji të kuptuarit e leximit janë *Planet e vetëdijshme dhe fleksibile që lexuesit zbatojnë dhe përshtatësin në një shumëllojshmëri të teksteve dhe detyrave*” (Samuels, 2006). Sipas autorëve të tjerë përdorimi i aktiviteteve të ndryshme nxitëse të të kuptuarit si strategjitë, është për shkak të intencës së ndarjes së e vëmendjes së lexuesit në mënyrë që të përqëndrohet në pikat kryesore në vend se në detajet e vogla që vij nga teksti. Lexuesit e mirë planifikojnë dhe monitorojnë leximin e tyre në një nivel metakognitiv. E gjithë ajo çfarë bëjnë lexuesit është të menduarit në lidhje me zbatimin e strategjisë që ata do të kenë nevojë për të kuptuar të lexuarit e tekstit.

Lexuesit e një niveli metakognitiv aplikojnë një shumëllojshmëri të strategjive të duhura si plane të vetëdijshme që do të ndikojnë në leximin e tyre, si: strategji për të lidh përvojën e tyre me tekstin, deshifrim të fjalëve, të kuptuarit e fjalës, identifikim të ideve kryesore të të lexuarës, analizë dhe sintezë të informacionit, e të ngjashme, përderisa të kuptuarit e tyre do të shtrihet përtej të kuptuarit tekstual. Para, gjatë dhe pas leximit, gjatë përmbledhjes dhe reflektimit lexuesit e suksesshëm mbështeten në strategjitë kognitive dhe metakognitive ku parashtrojnë pyetje dhe përpiqen të përgjigjen duke kërkuar përgjigjet në të lexuarën pa mos anashkaluar ndër lidhjen me të para njohurën.

Aleksandër dhe Judy, definojnë strategjitë e të kuptuarit të leximit si procedura të drejtuara kah qëllimi të cilat janë të qëllimisht të planifikuara dhe shkaktuara si ndihmë në rregullim, ekzekutim dhe vlerësim të detyrës (Alexander, 1988). Strategji të cilët do të zgjerojnë të kuptuarit e leximit mund të jenë edhe pyetje të cilët lexuesi vet mund të parashtrojë para, gjatë dhe pas të lexuarit me qëllim të krijojë imazhe vizuale, të bëjë vlerësime kritike në lidhje me të lexuarën, të krijojë interpretime unike, e të ngjashme, si:

- A e kam të njohur këtë prej më parë?
- Çfarë pamjesh më pasqyron ky tekst në mendjen time?
- Si mund të më ndihmojnë këto pamje të kuptoj tekstin në mirë?
- Pse autori e ka shkruar atë?
- A ka kuptim?
- A e gjej veten unë të ky tekst?
- A mund ta them unë këtë me fjalë të mija?
- Kush është tema dhe ideja kryesore në këtë tekst?
- Çfarë gjuhe ka përdor autori?
- A më përkujton ky tekst ndonjë përjetim nga jeta apo nga ndonjë e lexuar?

## Shembuj të strategjive efektive të të kuptuarit të leximit

Strategjitë janë mënyra të pashkëputshme pa të cilat procesi i të kuptuarit të leximit vështirë mund të arrijë objektivat e saja. Shumica e rezultateve lidhur kërkimeve që në dekadat e fundit është preokupim i shumë shkencëtarëve bazohen rreth pyetjes se si të ritet niveli i të kuptuarit të leximit dhe si lexuesit të bashkëveprojnë me tekstin. Është konstatuar se përdorimi i një game të gjerë të strategjive është rruga më e sigurt që shpie në këtë qëllim, gjegjësisht lehtëson ndërtimin e kuptimit dhe mundëson që lexuesit të shëndrohen në lexues metakognitiv

dhe intuitivisht bëhen lexues strategjik, reflektuar nga aftësia për përdorim të drejtë të strategjive kognitive.

Përveç një farë njohurish paraprake me të cilat lexuesit kuptojnë ligjërimin gojor apo një tekst të shkruar, ata kanë nevojë edhe për shprehje dhe strategji. Shprehjet janë proceset që nxënësve u janë bërë zakon t'i përdorin. Strategjitë janë po këto procese, por nën kontroll të vetëdijshëm. Mësuesit duhet të dinë shprehjet dhe strategjitë që zotërojnë nxënësit për të krijuar një repertor të qëndrueshëm të tyre tek të gjithë nxënësit. Më vonë, ndoshta shumë më vonë, me nxitje të vazhdueshme nga mësuesi, kur nxënësit i bëhet zakon të përdorë kontekstin, për të gjetur kuptimin e fjalëve të reja, kjo veprimtari kthehet në shprehje.

Lexuesit kërkojnë zakone dhe taktika përveç disa njohurive paraprake për të kuptuar bisedën e shkruar ose të folur. Shprehjet janë proceset, që nxënësve u janë bërë zakon t'i përdorin. I vetmi ndryshim me strategjitë është se ato kontrollohen me vetëdije. Për të zhvilluar një repertor standard zakonesh dhe teknikash të secili nxënës, mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për zakonet dhe strategjitë që zotëron çdo nxënës. Ky veprim zhvillohet në një zakon kur studentët përdorin kontekstin për të përcaktuar kuptimin e fjalëve të reja me nxitjen e një mësuesi vite më vonë.

Për shkak të stileve të ndryshme të leximit, të gjithë lexuesit nuk mund të përdorin në mënyrë të njëjtë strategjitë. Përderisa një strategji e veçantë mund të sigurojë çelësin për të kaluar lehtë një vështirësi leximi, strategjia e njëjtë mund të mos jetë aq e dobishme për lexuesin tjetër. Mu për këtë arsye nxënësve duhet t'u servohen strategji të ndryshme e cila do të paraqes një mundësi për të reflektuar mbi efektivitetin e strategjisë zbatimin e të cilëve duhet praktikuar qysh nga klasat më të hershme të cilët do të ndihmojnë ato të aftësohen si lexues aktiv. Aplikimi i strategjive do të lejojë përballjen me shkrime gjithnjë e më të vështira, duke mos evituar nevojën për përshtatje të strategjive të cilët përkrijnë shkallën në përputhje me nivelin klasor dhe me tekstin përkatës.

Strategji të dëshmuara për përmirësim të kuptuarit të leximit janë:

- Parashikimi i tekstit
- Parashtrimi i pyetjeve
- Krijim i lidhjeve
- Vizualizimi
- Njohja rreth funksionimit të fjalëve
- Monitorimi
- Përmbledhja
- Vlerësimi

## **Parashikimi**

Në thelbin e saj parashikimi është strategji e cila vjen para procesit të leximit me parashikim për të shkruarën ku vjen në shprehje aktivizimi i njohurive paraprake dhe parapamja. Është mjaft inkurajues fakti së nxënësit përdorin njohuritë e tyre ekzistuese për të lehtësuar të kuptuarit e ideve të reja që hasen në tekst, të cilën Anderson dhe Pearson e emërtojnë si urë mes të njohurës dhe të rejës (Pearson, 2002). Aktivitetet dominuese gjatë kësaj strategjie janë parashikimi dhe ngjallja e parajnohurive paraprake rreth temës, përmbajtjes dhe strukturës së të lexuarës. Në të dy rastet nxënësit inkurajohen të gjenerojnë pritjet e tyre rreth asaj se çfarë personazhet në tregim mund të bëjnë parashikime të bazuara nga përvojat vetanake ose nga situata të ngjashme të lexuara a hasura më parë. Sipas studimeve këta përpjekje të parashikimit janë treguar shumë të suksesshme në rritjen e interesimit dhe memorimin e tregimeve, edhe atë Pearson, Anderson dhe Fielding theksojnë efektin vetëm atëherë nëse parashikimet janë krahasuar në mënyrë të qartë me idetë e tekstit gjatë leximit të mëtejshëm, duke sugjeruar se procesi i verifikimit integron krahasimin e njohurive në mënyrë eksplicite.

Gjatë parashikimit nxënësit mendojnë për atë që tashmë e dinë dhe e përdorin këtë njohuri në lidhje me të dhëna të tjera për të ndërtuar kuptim nga ajo që ata lexojnë ose hamenden se çfarë do të ndodhë më tej në tekst. Vendosija e objektivit të përqendrimit ndihmohet nga kjo strategji, shkathtësi e cila reflektohet nga ndonjë fjalë kyçe e hasur në tekst, ose mund të bazohet nga vet titulli i tekstit. Supozohet se nxënësit do të vazhdojnë për të lexuar për të parë nëse parashikimet e tyre janë të sakta. Ajo është një proces i vazhdueshëm që në mënyrë aktive angazhohet lexuesit në dy mënyra: të menduarit e lexuesit që është gjithmonë një hap përpara, dhe momenti tjetër është përpjekja që në të njëjtën kohë lexuesi të rishikojë e rafinojë parashikimet vjetra. I gjithë ky angazhim mban aktiv lexuesin në procesin e leximit e cila njëkohësisht është çelësi për të kuptuar dhe lexuesi vazhdimisht mbetet i motivuar dhe përqendruar.

## **Parashtrimi i pyetjeve**

Parashtrimi i pyetjeve përmban elemente kyçe për të kuptuar të lexuarën si dhe ndikojnë në rrjedhën dhe në nxitjen e të menduarit të nxënësve. Parashtrimi i pyetjeve drejton vëmendjen kah elementet strukturorë e të detajuar të të lexuarës, si: karakteret e tregimit, zhvillimi kronologjik i ngjarjes, problemi, shkakut dhe pasojat, zgjedhja e konfliktit, përcaktimi i temës e idesë, marrëdhëniet hierarkike të idesë, porosia, etj. Parashtrimi i pyetjeve realizohen para leximit e involvuar në strategjinë e parashikimit, realizohet gjatë dhe pas leximit. Mënyra dhe niveli i parashtrimit të pyetjeve, përkatësisht përjetimi i pyetjeve e cila vjen nga instruktive të qëndrueshme dhe qëllimshme nga mësimdhënësi do të kthejë në shprehje parashtrim të pyetjeve faktike për të marrë hollësi faktike.

Nga ana tjetër, takimi i ardhshëm me tekstin nga ana e nxënësit do të nxis parashtrimin e pyetjeve që kërkojnë pyetje të detajuara ose kuptim më të përgjithshëm. Kur nxënësit përjetojnë shpesh pyetje që kërkojnë nga to të lidhin informacionin nga teksti me njohuritë e tyre bazë, ato do të tentojnë të përqendrohen në këtë sjellje integrale në të ardhmen (Hansen, 1981). Parashtrimi i llojeve të ndryshme të pyetjeve në procesin e të kuptuarit të leximit dhe zhvillim të aftësisë të të menduarit kritik është mjaft e rëndësishme edhe atë nëse parashtrijmë pyetje të natyrës faktike, parashikuese dhe konkluduese.

Parashtrimi i pyetjeve *faktike* bazohen dhe gjenden drejtpërdrejtë në tekst të cilat bazohen në fakte të nxjerra nga e lexuara, ato *parashikuese* që kërkojnë që të mendojnë për atë se çka mund të ndodhë në tregim, bazuar në atë që e dinë deri aty, dhe ato konkluduese, pyetje që kërkojnë nga nxënësit të nxjerrin përfundime të bazuara në të dhënat në tregim. Këta tipa të pyetjeve janë të lidhura me aftësitë kognitive të nxënësve. Ata shkojnë në drejtim të kërkesave më të larta kognitive, ku pyetjet faktike janë më të lehta për tu përgjigjur në krahasim me ato konkluduese të cilat i takojnë nivelit më të lartë të aftësive të të menduarit. Është thelbësore se zbatimi i tipave të ndryshme të pyetjeve, ndihmojnë të kuptuarit dhe të menduarit kritik.

Është mjaft e rëndësishme të shqyrtojmë edhe Taksonominë e Objektivave Arsimore e Benjamin Blumit dhe bashkëpunëtorëve të tij, e cila përveç që është një konstrukt i rëndësishëm për vlerësim, ajo njëlloj mundëson manipulimin e llojeve apo “niveleve” të të menduarit. Blum për taksonominë deklaroi se bën të mundur dallimin e pyetjeve që bën mësuesi, midis atyre të “rendit të ulët” dhe të “rendit të lartë”: pra midis pyetjeve që kërkojnë njohjen apo mbajtjen mend të fakteve dhe kuptimin e koncepteve e të ideve (skaji i ulët), përkundrajt pyetjeve (kalojmë në skajin e lartë) që kërkojnë zbatimin e ideve, analizën e argumenteve, sintezën e disa ideve për të arritur në zgjidhje të reja, si dhe vlerësimin e një linje të tërë arsytimi. Angazhimi i nxënësve në procesin e gjenerimit të pyetjeve në lidhje me tekstet e lexuara dhe se çfarë ndikimi kjo sjellje gjeneruese mund të ketë më vonë në të kuptuarit e mëvonshëm të tekstit, edhe pse jo definitive, në përgjithësi është pozitive dhe inkurajuese (Pearson, *Effective practices for developing reading comprehension*, 2002).

Por, parashtrimi i pyetjeve nuk sjell gjithmonë të njëjtat efekte. Nga një studim të tre grupeve, ku në grupin e parë mësuesit parashtron pyetje, në grupin e dytë nxënësit parashtrojnë pyetje dhe në grupin e tretë ku nxënësit vet gjenerojnë pyetje të lidhur me ndonjë element faktik të mbështetura në njohurinë paraprake dhe të pajisur me rutinën metakognitive (e njohur si QAR – Question-Answer-Relationships), rezultoi se grupi i dytë dhe tretë patën arritje më të larta në pastest. Edhe pse kjo nuk ishte performanca më e lartë mbi vlerësimet e të kuptuarit, grupi i tretë, ata që janë të pajisur me rutinën shtesë metakognitive, ishin më të mirë në shpjegimin e proceseve që përdoren për t'iu përgjigjur pyetjeve.

## Krijim i lidhjeve

Krijimi i lidhjeve është një nga strategjitë e shumta të cilët ndihmojnë në kuptuarit e leximit. Është fakt se lexuesit do të argëtohen dhe do të lexojnë më tepër po qe se gjejnë tekstin të cilët i lidh ato. Relacioni i cili mund të arrihet me të lexuarën nëpërmjet krijimit të lidhjeve është lidhja me një paragraf, libër ose fakte nga bota, gjegjësisht ndihmon nxënësit të kuptojnë qëllimin e autorit. Sipas Keene dhe Zimmerman, të kuptuarit e leximit arrin stadin më të lartë atëherë kur bëjnë lidhjet si në vijim:

- Tekstin me veten (lexuesin)
- Tekstin me tekst (tekst tjetër të lexuar)
- Tekstin me botën

Lidhja *Teksti me veten* pasqyron lidhjen në mes të tekstit dhe ndonjë eksperiencë në jetën e tyre. Zbatimi i kësaj strategjie zgjon lidhjet personale me pjesën e lexuar. Për atë se krijimi i lidhjeve të tekstit me veten, Cris Tovani ofron këta arye:

- Ndihmon lexuesit të kuptojnë se si personazhet ndihen dhe motivimi prapa veprimeve të tyre;
- Ndihmon lexuesit të kenë një pasqyrë më të qartë përderisa lexojnë duke e bërë lexuesin më të angazhuar;
- Vendos qëllimin për lexim dhe e mban lexuesin të përqendruar;
- Detyron lexuesin të jenë të përfshirë në mënyrë aktive;
- Ndihmon lexuesit të kujtojnë arsyen pse ata kanë lexuar dhe të parashtrojnë pyetje në lidhje me tekstin. (Tovani, 2000)

Pyetje të cilat reforcjnë këtë strategji janë ato si: çfarë më përkujton ky tekst me jetën time?; çfarë është e ngjashme apo dallon nga jeta ime?; a ka diçka që mua më herët më ka ndodhur?; si kjo lidhet me jetën time?; çfarë ndjenje përjetoj/ova kur e lexova këtë?, etj. Lidhja *Teksti me tekstin* pasqyron lidhjen që ekziston në mes tekstit aktual me një tekst të lexuar më parë. E gjithë kjo lidhje ndodh atëherë kur lexuesi përkujtohet se kjo e lexuar i ngjason me një libër tjetër. Lexuesit vërejnë stilin e njëjtë të shkruarit të autorëve të ndryshëm apo temën që përshkon të gjithë në shkrimin e tyre.

Kur nxënësit arrijnë të bëjnë një vëzhgim në lidhje me karakteristikat e përbashkëta të tekstit, ata janë duke bërë lidhjen tekstin me tekstin, të cilat reflekton nga përvoja e gjerë e leximit dhe aftësojnë ato në krijimin e lidhjeve të tilla. Kjo strategji mban të lidhur lexuesin duke parashtruar pyetjet si: çfarë është ajo që më përkujton se e kam lexuar në një tekst tjetër?; çfarë ngjason apo dallon me tekst tjetër që kam lexuar?, etj. E quajtur si *Lidhja e Tekstit me botën* lidh të lexuarën dhe asaj se çfarë ata kanë mësuar për gjërat nëpërmjet televizorit, revistave, filmave, dokumentarëve, dhe medimeve tjera.

E lexuara që ngjall njohuritë e tyre prej momenteve tjera të dëgjua më herët dhe lidhjen e tyre, forcohet duke parashtruar pyetjet si: çfarë më përkujton këtu me të vërtetat që ndodhin në botën reale; çfarë janë ato ngjashmëri apo dallime që ndodhin në botën reale?, etj. Duke e ditur rëndësinë e krijimit të lidhjeve dhe duke qenë të vetëdijshëm se po kjo ndërlidhje është çelës për rritjen e të kuptuarit të tyre, lexuesit e suksesshëm bëjnë lidhje me qëllim të ndihmohen

për tu identifikuar me tekstin, të mbajnë në mend informacione të rëndësishme si dhe të thellojnë të kuptuarit e leximit në një nivel më të lartë, gjithmonë duke menduar “Kjo më kujton ... sepse ...” “Kjo pjesë është si ... sepse ...” Më kujtohet një kohë si kjo, kur ... dhe “Kjo më ndihmon të kuptoj se çfarë jam duke lexuar tani, ....sepse ...”.

## **Vizualizimi**

Është shprehje shumë e vjetër e cila thotë se një foto vlen sa një mijë fjalë. Kur bisedohet për kuptimin, kjo thënie mund të parafrazohet, një shfaqje vizuale ndihmon lexuesit të kuptojnë, të organizojnë dhe të mbajnë në mend disa nga këta fjalë. Për shkak të faktit se nxënësit çdo ditë e më shumë janë të atakuar nga shkenca dinamike e teknologjisë me imazhe nga televizori lojëra video, dhe shumë nga teknologjitë bashkëkohore, ekziston rreziku nga pranimi i leximit si aktivitet shumë pasiv.

Mu për këtë arsye vizualizimi, mund të transformojë qëndrimin e nxënësve të të gjithë moshave nga lexues pasiv në aktiv, si dhe lejon prezantimin vizual i cili mundëson krijimin e ideve konkrete dhe abstrakte rreth të lexuarës, krijimin e marrëdhënieve me tekstin (krijim të lidhjeve) si dhe pa mos anashkaluar arsyen shumë të shëndoshë, se e njëjta do të ngrijë nivelin e të kuptuarit. Vizualizimi ndihmon lexuesin të angazhohet në të lexuarit e tij derisa të mishërojë dhe të bëjnë atë të paharrueshme. Gjatë adaptimit të imazheve mentale ata vazhdojnë të lexojnë dhe e bëjnë leximin tredimensional. Prezantimi vizual ndihmon lexuesin të shqyrtojë tekstin duke kërkuar idetë konkrete dhe abstrakte rreth të lexuarës.

Lexuesit e aftë gjatë dhe pas leximit spontanisht dhe me qëllim krijojnë imazhe mendore. Imazhet dalin nga pesë shqisat si dhe emocionet dhe mbështeten në njohuritë paraprake të lexuesit (Keene, 2007). Përdorimi i qartë i hartave hapësinore, teknikave vizuale dhe metodave të ngjashme lehtësojnë të kuptuarit e asaj që theksohet dhe rikthimin e mëvonshëm hierarkik. Provat zakonisht përputhen me këtë premisë (Zenki-Dalipi, 2023). Prezantimet grafike si teknika të cilat mbështesin vizualizimin si strategji, ku nxënësit në mënyrë të drejtpërdrejtë përfaqësojnë mendimin e tyre dhe të kuptuarit nëpërmjet organizatorëve grafikë si: organizator hierarkik, organizator krahasues, organizator vazhdues, diagrami i Venit, harta semantike, harta merimangë, organizatori shkak / efekt, harta e karaktereve, seri e ngjarjeve zinxhir, etj.

## **Njohja si funksionojnë fjalët**

Zhvillimi i drejtpërdrejtë i fjalorit shpalos edhe një strategji të fuqishme dhe efektive mbi të kuptuarit të leximit. Si faktor mjaft i rëndësishëm, njohuria mbi funksionimin e fjalëve ndihmon mjaft nxënësit në deshifrimin e çelësave përmbajtësor, të sjellin konkluzione nga fjalët kyçe, të mund të parashikojnë nga fjalë kyçe, si dhe të gjykojnë dhe përkthejnë fjalët e panjohura nga kuptimi i vet tekstit. Përveç pasurimit të diapazonit të fjalorit, lexuesit strategjik nëpërmes kësaj shkathtësie gjejnë kuptimin e fjalës së panjohur. Është e pamundshme që një lexues të dijë një numër aq të madh të fjalëve me të cilat do të ndeshet, prandaj sugjerohet që mësuesit të mësojnë nxënësit e tyre se si të mësojnë kuptimet e fjalëve të reja. E gjithë kjo shkathtësi arrihet duke praktikuar atakimin e fjalëve të reja gjatë leximit duke:

- ndërlidhur kuptimin e fjalës përkrah marrëdhënies të fjalëve shoqëruese
- përdorur paranjohuritë dhe eksperiencat personale
- përdorur çelësat kuptimor

## Monitorimi

Të kuptuarit e leximit përfshin shumë aftësi perceptuese dhe njohëse, por edhe aftësia për të monitoruar nivelin e të kuptuarit është komponent i rëndësishëm. Kjo strategji përfshin reflektim mbi gjendjen e të kuptuarit, e cila duhet të jetë fleksibile dhe e përshtatshme.

Monitorimi i të kuptuarit gjatë leximit është koncept i cili thekson vëmendjen e dyfishtë, ku njëra anë përqendrohet në mësimin e materialit që duhet lexuar dhe nga ana tjetër vazhdimisht të kontrollosh se a je duke e realizuar kryerjen e këtyre operacioneve mendore që prodhojnë të mësuarit. E gjithë kjo do të thotë se në të njëjtën kohë duhet lexuar dhe nga ana tjetër të përpiqesh të kontrollosh a je duke e kuptuar të lexuarën. Monitorimi i të kuptuarit është një aspekt i rëndësishëm i leximit dhe zhvillimit njohës, strategji e cila bazohet në prova paraprake dhe diferencon lexuesit fillestar dhe ato të një niveli më të lartë të kuptuarit të leximit.

## Përmbledhja

Përmbledhja si detyrë vë në shprehje aftësinë e lexuesit për të zbërthyer tekstin me qëllim të klasifikojnë ngjarjet më të rëndësishme nga ato të parëndësishme. Kjo strategji kërkon aplikimin e nivelit më të lartë të të menduarit pasi në këtë pjesë ato analizojnë dhe sintetizojnë të dhënat dhe përmbledhin ato në përputhje me të lexuarën. Gjallërimi i kësaj strategjie vjen atëherë kur lexuesi do të jetë i aftë të largojë të gjithë detajet e tepërta dhe të panevojshme, të fokusohen në thelbësoren, të kërkojnë fjalët kyçe, të jetë i aftë të ruajë idetë kryesore dhe detajet thelbësore që mbështesin ato, si dhe të mbajë shënime koncize me të cilën do të mund të kryejë lidhjen.

Organizatorët grafik dhe teknika të ndryshme njëlloj janë të dëshirueshëm për të ushtruar përmbledhjen, ku nga nxënësit hap pas hapi do të kërkojnë nga informatat e dhëna në grafikone të krijojnë një përmbledhje të shkurtuar, si: përmbledhje me një fjalë (zbatim i të menduarit më të lartë e kritik ku me një fjalë të vetme lexuesi do të përmbledh tërësinë), mendo dhe ndaj në çift (aktivitet i cili siguron që të gjithë lexuesit bashkëveprojmë me informacionin dhe e ndajnë në çift), topi i përmbledhjes (mësuesi hedh topin nxënësit i cili qëndron në rreth dhe kërkon që për ca sekonda të tregojë ndonjë ide, fakt ose koncept nga teksti), etj.

## Vlerësimi

Vlerësimi si strategji vjen prej kontaktit të parë të lexuesit me tekstin, gjatë dhe pas leximit. Momenti i parë është përballja me titullin e të shkruarës e cila do të nxis apo jo lexuesin për të lexuar të njëjtin, emrin e autorit, nëse e kanë të njohur atë nga libra apo kanë pasur përvoja me të, a është tekst i cili është rekomanduar nga lexues të tjerë, tematika e saj përkon me interesin e dëshirat e lexuesit, sa e shkruara shoqërohet me ilustrime tërheqëse, etj. Kjo është vlerësimi i parë dhe krijimi i lidhjeve me tekstin. Të lexuarit e llojeve të ndryshme të shkrimeve dhe të kuptuarit e tyre kërkon përfshirjen e qasjeve dhe strategjive të ndryshme të leximit. Shndrimi i leximit si proces aktiv dhe proces i cili vazhdimisht mbikëqyret dhe vlerësohet sjell një ndërveprim që në vete sjell dhe zhvillon një kuptim të informatave, e cila arritje jo më pak do të realizohet duke përdorur aktivitete siç janë strategjitë e lartpërmendura dhe organizatorë grafik.

## References

- [1]. Alexander, P. A. (1988). The interaction of domain-specific and strategic knowledge in academic performance. *Review of Educational Research*, 58(4), 375–404.
- [2]. Dijk, T. &. (1983). *Strategies of discourse comprehension*. New York: Academic Press.
- [3]. Hansen, J. (1981). The effects of inference training and practice on young children's reading comprehension. *Reading Research Quarterly*, 391-417.

- [4]. Keene, E. O. (2007). *Mosaic of Thought The Power of Comprehension Strategy Instruction*. HEINEMANN Portsmouth, NH.
- [5]. Paris, G. W. (1991). *The development of strategic readers*. NY: White Plains.
- [6]. Pearson, D. &. (2002). Effective practices for developing reading comprehension. *Scholastic red*.
- [7]. Pearson, D. &. (2002). Effective practices for developing reading comprehension. *Scholastic red*, 13.
- [8]. Pressley, M. &. (2002). *Comprehension instruction: Research-based best practices*. New York: Guilford Press.
- [9]. Samuels, S. .. (2006). Samuels, S .J. & Farstrup, A. E. (Eds.), What research has to say about reading instruction (2nd ed.). *International Reading Association*, New York.
- [10]. Tovani, C. (2000). *I read it, but I don't get it: Comprehension strategies for Adolescent readers*. Maine: Stenhouse Publishers.
- [11]. Zenki-Dalipi, A. (2023). Visualization In Natural Sciences. "*Başkent*" *Congress On Humanities And Social Sciences Proceedings Book*, 779-783.